



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
Shkolla e Mesme Profesionale
"Charles Telford Erickson"
Golem – Kavaje

shkollaemesmeagrobiznesgolem@yahoo.it

Tel.0693870484

Nr. 125 prot

Golem më 19, 03, 2024

Lenda: Njoftim për levizje paralele.

Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerezire
Drejtoria e Maredhenieve me Publikun
Agjencia Kombetare e Punesimit dhe Aftesive

Në mbështetje të Ligjit nr.15/2019 "Për nxitjen e punësimit", Ligjit nr.15/2017, datë 16.02.2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë", Udhëzimit nr.14 datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",

Ofruesi publik i AFP-se, Shkolla e Mesme Profesionale Charles Telford Erickson" Golem-Kavaje ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

-Pergjegjes i Bazes Prodhuese te Shkolles.

Kriteret e marrjes në punë të Pergjegjesit te Bazes Prodhuese.

Kandidati aplikues për Pergjegjes Baze të ofruesit publik të AFP-së duhet të përmbushë kriteret, si më poshtë:

1. Kriteret të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të organizimit dhe planifikimit strategjik, aftësi analitike për zgjidhjen e problemeve;

g) të demonstrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.

3. Kriteret e posaçme për përgjegjës Baze Prodhuese, që mbulon kulturën profesionale:

a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit “Master shkencor” (ose të barasvlershme)

në një nga fushat që lidhet me kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;

b) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”;

c) të ketë punuar të paktën 5 vjet në një ofrues publik të AFP-së;

d) të ketë njohuri të certifikuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit.

4. Të ketë përvojë pune të paktën 3 vjet në fushën që lidhet me kualifikimet profesionale profesionale të njërit prej drejtimeve mësimore të ofruesit të AFP-së.

Dokumentet e aplikimit.

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) letërmotivimin për pozicionin;

b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;

c) kartën e identitetit

d) diplomën;

e) librezën e punës;

f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;

k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda dates. 02 . 04 .2024.

Drejtor
Matilda Canaku

